



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 134/2 Prot.

Tiranë, më 19.03.2020

**V E N D I M**

Nr. 30, datë 19.03.2020

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 1, datë 09.11.2020, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, për dhënie të masës disiplinore “vërejtje” ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*, me detyrë “ Drejtor në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës nr. 881 prot., datë 12.11.2020, nëpunësi \*\*\*\*\* ka parashtruar pretendimin për disa parregullsi të kryera ose të lejuara nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, në lidhje me zhvillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezultojnë të vërtetuara që: Kërkuesi \*\*\*\*\* është prej shumë vjetësh, është nëpunës civil i konfirmuar, në pozicionin “Drejtor, në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” në Këshillin e Qarkut Dibër.

Shkaku i kësaj mosmarrëveshjeje ka lindur për arsye se, Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, në cilësinë e epërorit direkt, me aktin nr. 272 prot., datë 21.10.2020, ka filluar ecurinë disiplinore

me arsyetimin se, nëpunësi \*\*\*\*\* ka publikuar me dashje, në rrjetet e tij sociale informacione zyrtare, pa qenë i autorizuar, veprime të cilat kanë dëmtuar dhe cenuar figurën e nëpunësit civil dhe imazhin e institucionit.

Në zbatim të nenit 57, pika 4, germa “ç”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, shkeljet e mësipërme janë klasifikuar si shkelje të lehta dhe për shqyrtimin e tyre është caktuar data 23.10.2020.

Më marrjen dijeni për fillimin e ecurisë disiplinore, nëpunësi \*\*\*\*\* i është drejtuar epropolit direkt me shkresat nr. 272/1 prot., datë 21.10.2020 dhe nr. 272/2 prot., datë 22.10.2020, nëpërmjet të cilave ka kërkuar:

- a) *Ndryshimin e datës së takimit për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar, duke argumentuar se caktimi i saj vjen në kundërshtim me Kreun II, pikën 13, germa “ç”, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor”, duke i mohuar në këtë mënyrë të drejtën e paraqitjes së pretendimeve me shkrim;*
- b) *Vënien në dispozicion të provave dhe fakteve, të cilat materializojnë shkeljen e pretenduar, me qëllim njohjen e veprimeve për të cilat pretendohet se përbëjnë shkelje dhe dispozitave ligjore që janë shkelur për shkak të këtyre veprimeve.*

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, nëpunësi \*\*\*\*\* nuk ka marrë përgjigje për kërkesat e parashtruara në aktet e mësipërme, megjithatë, në datën e caktuar për zhvillimin e seancës dëgjimore (datë 23.10.2020), nëpunësi është paraqitur në zyrën e epropolit direkt, ku për shkak të mosprezencës së këtij të fundit, është njoftuar verbalisht nga nëpunësi i protokollit, për datën e seancës së ardhshme dëgjimore, më 26.10.2020.

Ndodhur në kushtet e mësipërme, ankuesi \*\*\*\*\* nëpërmjet shkresës nr.272/3 prot., datë 23.10.2020, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, ka kërkuar njoftimin në mënyrë zyrtare të orarit të takimit, për kryerjen e bashkëbisedimit.

Bazuar në këtë kërkesë, me shkresën nr. 272/4 prot., datë 02.11.2020, “Njoftim fillimi ecurie disiplinore”, nëpunësi është njoftuar sërish për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj tij. Në përmbajtje të këtij akti, parashtrohet se nëpunësi \*\*\*\*\* ka thyer disiplinën në punë, duke publikuar pa të drejtë, të dhëna konfidenciale që kanë lidhje me mënyrën e vendimmarrjes së Këshillit të Qarkut Dibër, të cilat në referencë të nenit 57, pika 4, germa “ç”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë klasifikuar si veprime të cilat kanë cenuar figurën e institucionit.

Nëpërmjet aktit të mësipërm, nëpunësit në fjalë i është kërkuar paraqitja me shkrim e sqarimeve dhe provave rreth shkeljes së pretenduar, në datën 05.11.2020, duke mos përcaktuar se cila do të jetë data e zhvillimit të seancës dëgjimore. Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës

nr.272/5 prot., datë 02.11.2020, ankuesi ka kërkuar përcaktimin e orës së seancës dëgjimore si dhe të drejtën për t'u njohur me materialet e dosjes disiplinore.

Sipas procesverbalit nr. 272/7 prot., datë 05.11.2020, në këtë datë rezulton të jetë zhvilluar seanca dëgjimore, në të cilën ankuesi ka paraqitur pretendimet e tij me shkrim rreth shkeljeve të pretenduara në ngarkim të tij (*shkresa nr. 272/6 prot., datë 05.11.2020*). Në përfundim të këtyre veprimeve administrative, Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, në cilësinë e eprorit direkt, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*”, e cila rezulton të jetë zbardhur me vendimin nr. 1, datë 09.11.2020.

Nisur nga sa më sipër në vlerësim të rrethanave dhe dokumentacionit të administruar, konstatohet se në zhvillimin e procedurës për marrjen e masës disiplinore ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* , janë kryer/lejuar disa shkelje të elementëve proceduralë, të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrive, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor*” dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, të cilat në mënyrë të përmbledhur po i rendisim këtu, më poshtë:

*Së pari*, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se, nga ana e eprorit direkt, Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër nuk është siguruar zhvillimi normal i procedurës disiplinore. Në Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për elementët kryesorë procedurale dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, përcaktohen në mënyrë eksplicite funksionet dhe detyrat e eprorit direkt në zhvillimin e ecurisë disiplinore.

Në kapitullin B, “*Detyrat e eprorit direkt gjatë procedimit disiplinor*”, të këtij udhëzimi, përcaktohet se, eprori direkt mban përgjegjësi për funksionimin e Sekretariatit Teknik, i cili siguron evidentimin dhe faktimin e të gjitha veprimeve të kryera nga eprori direkt, në kuadër të shqyrtimit të shkeljes disiplinore. Konkretisht, personi që kryen funksionin e Sekretariatit Teknik, ndër te tjera është përgjegjës për përgatitjen e njoftimeve për mbledhje si dhe përmbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

Referuar praktikës që materializon procedurën disiplinore në ngarkim të nëpunësit \*\*\*\*\* , konstatohet se me shkresën nr. 272 prot., datë 21.10.2020, është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore dhe zhvillimin e seancës së parë dëgjimore në datën 23.10.2020. Në lidhje me këtë seancë, nuk rezulton të jetë mbajtur ndonjë procesverbal, në të cilën të pasqyrohen arsyet e mosprezencës së eprorit direkt dhe shtyrjes së seancës dëgjimore. Për më tepër, konstatohet se, nuk ka asnjë vendim të ndërmjetëm të eprorit direkt në lidhje me ecurinë e procedimit disiplinor si dhe as njoftim në lidhje me datën e seancës së ardhshme dëgjimore.

Përpilimi i shkresës nr. 272/4 prot., datë 02.11.2020, nëpërmjet të cilës nëpunësi është njoftuar sërish për nisjen e ecurisë disiplinore, për të njëjtën shkelje të pretenduar më parë, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ka kuptimin e një përpjekje për ta formuluar më mirë shkakun që ka shërbyer për kryerjen e ecurisë disiplinore, por që si përfundim ka mbetur përsëri konfuze. Në këtë prizëm, kjo nuk mund të konsiderohet, siç pretendohet prej kërkuesit, si fillim i një ecurie të dytë disiplinore për të njëjtin shkak, gjë e cila do të binte në kundërshtim me nenin 60, pika 6), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili përcakton detyrimin e zhvillimit të një ecurie të vetme disiplinore, për të njëjtën shkelje të pretenduar dhe marrjen e një masë të vetme disiplinore.

Së dyti, evidentohen shkelje në rregullat dhe afatet ligjore të zhvillimit të ecurisë disiplinore, të cilat i kanë mohuar të drejtën e nëpunësit për t’u njohur me dosjen e hetimit disiplinor dhe për të paraqitur pretendimet e tij rreth shkeljeve të pretenduara.

Në udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesore procedurale dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, përcaktohet se eprori direkt njofton nëpunësin në lidhje me datën dhe vendin e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar. Sipas këtij udhëzimi, data e shqyrtimi të shkeljes së pretenduar nuk mund të caktohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësi, për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj tij.

Nga verifikimi i dokumentacionit që materializon ecurinë disiplinore në rastin konkret, konstatohet se nëpunësi është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore në datën 21.10.2020, ndërkohë që seanca dëgjimore është vendosur të zhvillohet në datën 23.10.2020.

Caktimi i kësaj seance vetëm 2 ditë pas njoftimit të fillimit të ecurisë disiplinore, përbën cenim të së drejtës legjitime të nëpunësit për t’u njohur me provat dhe faktet që vërtetojnë shkeljen disiplinore dhe përgatitur për ballafaqimin, për më tepër kur në rastin konkret, nuk rezulton që eprori direkt të ketë vënë në dispozicion të nëpunësit dokumentacionin provues shkresor.

Megjithatë, duke analizuar përmbajtjen e shkeljeve të renditura më sipër, arrijmë në përfundimin se ato nuk janë të natyrës që sjellin pavlefshmëri absolute të procesit administrativ të kryer, pasi në fakt nëpunësi ka marrë dijeni për shkakun e fillimit të ecurisë disiplinore dhe për veprimin që është konsideruar thyerje e disiplinës në punës.

Shkeljet e përmendura, në thelbin e tyre përbëjnë elementë kundraligjshmërie, të cilat nuk cenojnë vlefshmërinë e procesit administrativ të kryer, por që më poshtë do të vlerësohen në ndërthurje me elementë të tjerë të përmbajtjes së procesit, prandaj arsyetojmë:

Nga përmbajtja e procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 05.11.2020 dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, konstatohet se nga ana e eprorit direkt është arsyetuar se nëpunësi i proceduar, ka thyer disiplinën në punë pasi ka bërë publikimin në rrjetet sociale, të relacionit të përgatitur dhe paraqitur përpara Këshillit të Qarkut Dibër, për të argumentuar nevojën e ndryshimit të strukturës organizative të institucionit. Ky veprim i nëpunësit pa patur autorizimin përkatës, sipas eprorit, ka prishur imazhin e institucionit duke shkelur rregullat e funksionimit të administratës publike, por kjo nuk është shoqëruar me paraqitjen e ndonjë dokumentacioni shkresor apo fakti tjetër, që të provonte këtë prishje të imazhit të institucionit apo dëme të tjera, të ardhura nga ai veprim.

Duke analizuar përmbajtjen e veprimit të mësipërm të nëpunësit të proceduar disiplinarisht, arrijmë në konkluzionin se trajtimi i tij si thyerje e disiplinës në punë, ka lidhje me moskuptimin e drejtë prej eprorit direkt, të detyrimit dhe kërkesës për transparencë në punën e administratës publike, në kushtet e veprimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe parimit të transparencës, të sanksionuar në nenin 5, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, të cilët kanë për qëllim nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Për më tepër, në nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” janë përcaktuar kategoritë e informacioneve që duhet të bëhen publike pa kërkesë, në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet ku ndër të tjera përfshihen: një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik. etj.

Në kushtet e kuadrit ligjor të mësipërm, dhe kur në përmbajtjen e tij, relacioni i publikuar nuk kishte të dhëna personale apo sekrete shtetërore, arrihet në përfundimin se në veprimet e nëpunësit \*\*\*\*\* , nuk gjenden elementë të kundërligjshëm e për rrjedhojë as elementë të thyerjes së disiplinës në punë

Moskryerja e një hetimi të plotë administrativ dhe mungesa e një analize të plotë ligjore e rastit në fjalë, kanë patur ndikimin e vet edhe në përmbajtjen e vendimit nr. 1, datë 09.11.2020, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, “Për akordimin e masës disiplinore “Vërejtje” për nëpunësin \*\*\*\*\* me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Këshillin e Qarkut Dibër”, ku vërehet mungesa e arsyesimit të

vendimit dhe analiza e fakteve që janë bërë shkas për arritjen në konkluzionin e fajësisë së nëpunësit të proceduar.

Nisur nga sa është parashtruar më sipër, arrihet në përfundimin se, vendimi nr. 1, datë 09.11.2020, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, *“Për akordimin e masës disiplinore “Vërejtje” për nëpunësin \*\*\*\*\* me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Këshillin e Qarkut Dibër”*, është një akt administrativ i paligjshëm, në zbatim të nenit 109, pikat “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe për këto arsye, në referencë të neneve 113 e 114, pika 1, të po këtij ligji, duhet të shfuqizohet tërësisht

Më tej, me shfuqizimin e vendimit të epërorit direkt, si një akt i paligjshëm, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Dibër, duhet të marrë masa për fshirjen e masës disiplinore në ngarkim të nëpunësit \*\*\*\*\* nga regjistri qendror dhe dosja e personelit.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga njësia e burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Dibër, që të drejtojë procesin administrativ nëpërmjet të cilit, Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, në cilësinë e epërorit direkt, në zbatim të neneve 113 dhe 114, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të shfuqizojë vendimin nr. 1, datë 09.11.2020, *“Për akordimin e masës disiplinore “Vërejtje” për nëpunësin \*\*\*\*\* me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Këshillin e Qarkut Dibër”*, si një akt i nxjerrë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe nenit 109, pikat “d” dhe “dh”, të Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, të marrë masa për fshirjen e masës disiplinore të dhënë në ngarkim të nëpunësit \*\*\*\*\* , nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 10 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.

4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohet për këtë vendim Këshilli i Qarkut Dibër dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**